



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:121577
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05691953

C.nr.1949/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale S.F. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve P.K. me numër personal Z.S. me numër personal F.K. me numër personal R.P. me numër personal dhe L.P. me numër personal të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë av. B.K. dhe av. F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2223.7 euro, jashtë seance, me datë 16.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve P.K., Z.S., F.K., R.P. dhe L.P., të gjithë nga Prizreni, DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Paditësit P.K. në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj:
 - Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019 në shumën prej 45.67 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 5.80 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 103.79 euro,
 - apo shumën e përgjithshme prej 105.92 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.06.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.
2. Paditësit Z.S. në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj:
 - Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019 në shumën prej 93.61 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.88 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 202.08 euro,
 - apo shumën e përgjithshme prej 307.57 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.06.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.
3. Paditësit F.K. në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj:
 - Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019 në shumën prej 79.56 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;

- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro,
 - apo shumën e përgjithshme prej 261.42 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.06.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.
4. Padiësit R.P. në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj:
- Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019 në shumën prej 45.67 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 5.80 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 98.60 euro,
 - apo shumën e përgjithshme prej 150.07 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.06.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.
5. Padiësës L.P. në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj:
- Për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2019 në shumën prej 79.56 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
 - Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro,
 - apo shumën e përgjithshme prej 261.42 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.06.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë të padiësve përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi ashtu që padiësit P.K. iu refuzua shuma prej 150.92euro, padiësit Z.S. iu refuzua shuma prej 318.77 euro, padiësit F.K. iu refuzua shuma prej 272.94 euro, padiësit R.P. iu refuzua shuma prej 136.1 euro dhe padiësës L.P. iu refuzua shuma prej 258.57 euro.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që padiësve në emër të shpenzimeve të procedurës, tua paguaj shumën prej 342.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Padiësit P.K., Z.S., F.K., R.P. dhe L.P., të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë av. B.K. dhe av. F.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt. 14.06.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit-Prizren, me objekt të kontestit për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

I autorizuari i padiësve në padi ka theksuar, se padiësit janë të punësuar pranë SHFMU “Zef Lush Marku” në Velezhë, Komuna e Prizrenit, me kontratë pune në kohë të pacaktuar. Tutje, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Me ç'rast nga gjykata ka kërkuar që padiësit P.K. për periudhën kohore për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të vitit 2018, 2019, 2020 dhe 7 muaj të vitit 2021 ti paguhet shuma prej 256.84 euro, ndërsa padiësit Z.S. për periudhën kohore për 9 muaj të vitit 2017, 12

muaj të vitit 2018, 2019, 2020 dhe tërë vitin 2021 ti paguhet shuma prej 626.34 euro, paditësit F.K. për periudhën kohore për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të vitit 2018, 2019, 2020 dhe tërë vitin 2021 ti paguhet shuma prej 534.36 euro. Paditësit R.P. për periudhën kohore për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të vitit 2018, 2019, 2020 dhe tërë vitin 2021 ti paguhet shuma prej 286.17 euro dhe paditëses L.P. për periudhën kohore për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të vitit 2018, 2019, 2020 dhe tërë vitin 2021 ti paguhet shuma prej 519.99 euro.

Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.11.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, si dhe ka theksuar se disa paditës në këtë rast nuk janë mësimdhënës por janë ndihmës. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së, pasi që paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë paarshtuar me datë 14.06.2022. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimet të lëshuara nga këtu e paditura SHFMU “Zef Lush Marku” në Velezhë, Komuna e Prizrenit, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Zef Lush Marku” në Velezhë, Komuna Prizren. Sipas vërtetimit me nr. 90/22 e datës 15.02.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësin P.K., gjykata ka vërtetuar se i njejti ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 18.04.2017 deri me dt. 19.07.2021.

Në bazë të vërtetimit me nr. 71/2021 e datës 05.02.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësin Z.S. gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 18.04.2017 deri me datën 31.12.2021.

Në bazë të vërtetimit me nr. 65/2022 e datës 15.02.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësin F. K. gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 18.04.2017 deri me datën 31.12.2021.

Nga vërtetimi me nr. 92/2022 e datës 15.02.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësen R.P. gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka filluar të punoj tek e njëjta prej datës 18.04.2017 deri me datën 31.12.2021.

Nga vërtetimi me nr. 60/2022 e datës 15.02.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësen L.P. gjykata ka vërtetuar se e njëjta si mësimdhënëse ka filluar të punoj tek e njëjta prej datës 18.04.2017 deri me datën 31.12.2021.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve dhe atë, paditësit F.K. dhe L.P. si mësimdhënës kanë pagën bazë në shumë prej 421 euro, ndërsa paditësit P.K. dhe R.P. në bazë të koeficientit 4/1, si punëtor tek e paditura ka pagën bazë në shumë prej 241.68 euro dhe paditësi Z.S. i punësuar si drejtor tek e paditura, në bazë të koeficientit A-7.8/1 ka pagën bazë në shumë prej 495.30, të përcaktuara sipas Mendimit- vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e datës 11.12.2023. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësin P.K.

- Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 45.67 euro ($241.68 * 2.7\% = 6.52 * 7$ muaj = 45.67 euro).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.80 euro ($241.68 * 0.2\% = 0.48 * 12$ muaj = 5.80 euro).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 19.07.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.60 euro ($241.68 * 3.4\% = 8.21 * 6$ muaj = 49.26 euro), si dhe periudha 19 ditë të muajit Korrik është 5.19 euro sipas llogaritjes ($8.21/30 = 0.27 * 19$ ditë = 5.19 euro) = 49.26 + 5.19 = 54.45 euro.
- Apo për periudhën kohore prej dt. 01.05.2019 e deri me dt. 31.12.2021 i takon shuma e përgjithshme prej 105.92 euro.

Paditëses R.P.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 45.67 euro ($241.68 * 2.7\% = 6.52 * 7$ muaj = 45.67 euro).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.80 euro ($241.68 * 0.2\% = 0.48 * 12$ muaj = 5.80 euro).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.60 euro ($241.68 * 3.4\% = 8.21 * 12$ muaj = 98.60 euro).
- Apo për periudhën kohore prej dt. 01.05.2019 e deri me dt. 31.12.2021 i takon shuma e përgjithshme prej 150.07 euro.

Për paditësin Z.S.

- Për periudhën 01.06.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 495.30 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 93.61 euro ($495.30 * 2.7\% = 13.37 * 7$ muaj = 93.61 euro).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 495.30 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.88 euro ($495.30 * 0.2\% = 0.99 * 12$ muaj = 11.88 euro).

- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 495.30 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 202.08 euro ($495.30 * 3.4\% = 16.84 * 12 \text{ muaj} = 202.08 \text{ euro}$).
- Apo për periudhën kohore prej dt. 01.05.2019 e deri me dt. 31.12.2021 i takon shuma e përgjithshme prej 307.57 euro.

Paditësi F.K. dhe Paditësen L.P.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë të tyre është 79.56 euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 7 \text{ muaj} = 79.56 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë të tyre është 10.10 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë të tyre është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$).
- Apo secilit paditës veç e veç për periudhën kohore prej dt. 01.05.2019 e deri me dt. 31.12.2021 i takon shuma e përgjithshme prej 261.42 euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 14.06.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëseve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 31.05.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 2 vite e 2 muaj, ndërsa paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 14.06.2022.

Gjykata vendosi tu njoh kompensimin mbi rritjen e pagës për shkak të inflacionit bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021, ku

vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësve dhe atë paditësit P.K. si punëtor tek e paditura në bazë të koeficientit 4 realizon pagën bazë në shumë prej 241.68 euro dhe jo siç ka kërkuar në shumë prej 309.13 euro, paditësi Z.S. si drejtor i shkollës tek e paditura, në bazë të koeficientit A- 7.8/1 ka pagën bazë në shumë prej 495.30 euro, dhe jo siç i ka kërkuar në kërkesëpadinë pagën bazë në shumën prej 625.79 euro. Paditësi F.K. si mësimdhënës tek e paditura ka pagën bazë në shumë prej 421 euro dhe jo siç ka kërkuar në kërkesëpadi në shumë prej 533.84 euro. Paditësi R.P. si punëtor tek a paditura ka pagën bazë në shumë prej 241.68 euro dhe jo siç ka kërkuar në kërkesëpadinë shumën prej 286.17 euro, si dhe paditësja L.P. si mësimdhënëse tek e paditura ka pagën bazë në shumë prej 421 euro e jo siç ka kërkuar pagën në shumë prej 519.53 euro, pasi në këto shumë janë të përfshirë edhe shtesat tjera në pagë që i realizojnë paditësit, prandaj mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës për 2 vite e 2 muaj (nga data 18.04.2017 deri me dt. 31.05.2019) si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësit, në atë mënyrë që paditësit P.K. iu refuzua shuma prej 150.92euro, paditësit Z.S. iu refuzua shuma prej 318.77 euro, paditësit F.K. iu refuzua shuma prej 272.94 euro, paditësit R.P. iu refuzua shuma prej 136.1 euro dhe paditëses L.P. iu refuzua shuma prej 258.57 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (14.06.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.1949/2022, datë 16.05.2024

Gjyqtarja
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.